



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore**

**TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE**

**Tremujori I 2022**

## Përmbajtje

|   |   |
|---|---|
| I . HYRJE.....  | 3 |
| II. PANORAMË E PËRGJITHSHME .....                                 | 3 |
| III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE .....                                | 4 |
| 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare .....                | 4 |
| 2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare ..... | 7 |
| 3. Treguesit e shërbimit jo universal postar .....                | 7 |
| 4. Treguesit e shërbimit ekspres.....                             | 8 |

## I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e parë të vitit 2022 dhe krahasimet me tremujorin e katërt të vitit 2021 dhe me tremujorin e parë të vitit 2021, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al), në seksionin “Statistika rreth AKEP”-“Shërbimet Postare”

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

## II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e parë të vitit 2022 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (33 subjekte):**

1. Albanian Cargo Service sh.p.k.
2. Albanian Delivery Express sh.p.k.
3. Albanian Parcel Distribution sh.p.k.
4. Alfa Courier Services sh.p.k.
5. Alopост sh.p.k.
6. Armonela Bala (Person fizik)
7. B.E.D. sh.p.k.
8. Balkan Courier & Logistics sh.p.k.
9. Bee Courier & Logistics sh.p.k.
10. BIPEX sh.p.k.
11. Blendi Dokollari (Flash Delivery Albania)
12. COEX sh.p.k.
13. Courier Group sh.p.k.
14. DHL International (Albania) sh.p.k.
15. Express ALB 24
16. Express Delivery Tirana sh.p.k.
17. Fast Express Post sh.p.k.
18. Fenix Post & Delivery Albania sh.p.k.
19. Greenposta shpk
20. I V Y sh.p.k.
21. IDEX Ideal Express sh.p.k.
22. Intex Courier sh.p.k.
23. IPOST sh.p.k.

24. Mr. Courier sh.p.k.
25. NOEX Courier & Delivery sh.p.k.
26. Posta Jonë
27. Sanije Memlika (Person fizik)
28. T.N.T Express Albania sh.p.k.
29. Top Post sh.p.k.
30. Turboo Albania sh.p.k.
31. Ulysses Enterprises sh.p.k.
32. United Transport sh.p.k.
33. Youth Albania Professional Services

Gjatë periudhës, nga tremujori i katërt i vitit 2021 deri në tremujorin e parë të vitit 2022, janë ç'regjistruar 2 subjekte për ofrimin e shërbimeve postare dhe kanë raportuar të dhënat statistikore 22 subjekte<sup>1</sup>.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

### III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres

#### 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 rezultojnë 6,565,007 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

---

<sup>1</sup> Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më, 20.04.2022

**Tabela 1.1:** Të dhëna përmblendhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

| Shërbime postare të ofruara                   | T1_2020          | T2_2020          | T3_2020          | T4_2020          | T1_2021          | T2_2021          | T3_2021          | T4_2021          | T1_2022          | Ndryshim<br>T1_2022/<br>T4_2021 | Ndryshim<br>T1_2022/<br>T1_2021 |
|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| <b>Posta Shqiptare sh.a</b>                   |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| <b>1 Shërbim Universal Postar</b>             |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 1.1 Postë brenda vendit                       | 5,306,046        | 2,905,495        | 4,515,612        | 4,760,385        | 4,989,939        | 4,956,577        | 5,113,495        | 5,159,865        | 5,087,129        | -1.4%                           | 2%                              |
| 1.2 Postë ndërkombëtare                       | 162,172          | 73,152           | 449,011          | 219,001          | 175,779          | 161,672          | 155,708          | 169,788          | 158,687          | -6.5%                           | -10%                            |
| <b>1.3 Totali 1.1+1.2</b>                     | <b>5,468,218</b> | <b>2,978,647</b> | <b>4,964,623</b> | <b>4,979,386</b> | <b>5,165,718</b> | <b>5,118,249</b> | <b>5,269,203</b> | <b>5,329,653</b> | <b>5,245,816</b> | <b>-1.6%</b>                    | <b>2%</b>                       |
| <b>2 Shërbim jouniversal postar</b>           |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 2.1 Postë brenda vendit                       | 330,349          | 165,027          | 188,496          | 189,640          | 136,189          | 67,381           | 117,301          | 16,320           | 80,114           | 390.9%                          | -41%                            |
| 2.2 Postë ndërkombëtare                       | 620              | 290              | 159              | 198              | 388              | 341              | 707              | 458              | 381              | -16.8%                          | -2%                             |
| <b>2.3 Totali 2.1+2.2</b>                     | <b>330,969</b>   | <b>165,317</b>   | <b>188,655</b>   | <b>189,838</b>   | <b>136,577</b>   | <b>67,722</b>    | <b>118,008</b>   | <b>16,778</b>    | <b>80,495</b>    | <b>379.8%</b>                   | <b>-41%</b>                     |
| <b>3 Shërbim ekspres</b>                      |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 3.1 Ekspres brenda vendit                     | 138,772          | 126,563          | 120,632          | 100,564          | 144,200          | 168,882          | 183,171          | 173,684          | 156,598          | -9.8%                           | 9%                              |
| 3.2 Ekspres ndërkombëtar                      | 3,465            | 1,988            | 3,986            | 3,435            | 4,779            | 5,018            | 4,515            | 4,534            | 4,992            | 10.1%                           | 4%                              |
| <b>3.3 Totali 3.1+3.2</b>                     | <b>142,237</b>   | <b>128,551</b>   | <b>124,618</b>   | <b>103,999</b>   | <b>148,979</b>   | <b>173,900</b>   | <b>187,686</b>   | <b>178,218</b>   | <b>161,590</b>   | <b>-9.3%</b>                    | <b>8%</b>                       |
| <b>Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare</b> |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| <b>4 Shërbim JoUniversal Postar</b>           |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 4.1 Postë brenda vendit                       | 221,482          | 484,711          | 701,719          | 677,751          | 720,541          | 513,925          | 365,123          | 333,541          | 331,957          | -0.5%                           | -54%                            |
| 4.2 Postë ndërkombëtare                       | 9,650            | 10,609           | 13,202           | 25,668           | 16,830           | 9,200            | 19,026           | 14,774           | 16,286           | 10.2%                           | -3%                             |
| <b>4.3 Totali 4.1+4.2</b>                     | <b>231,132</b>   | <b>495,320</b>   | <b>714,921</b>   | <b>703,419</b>   | <b>737,371</b>   | <b>523,125</b>   | <b>384,149</b>   | <b>348,315</b>   | <b>348,243</b>   | <b>0.0%</b>                     | <b>-53%</b>                     |
| <b>5 Shërbim ekspres</b>                      |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 5.1 Ekspres brenda vendit                     | 588,199          | 630,510          | 769,419          | 788,390          | 683,062          | 724,847          | 927,403          | 915,309          | 670,509          | -26.7%                          | -2%                             |
| 5.2 Ekspres ndërkombëtar                      | 52,892           | 56,336           | 77,529           | 83,771           | 68,688           | 53,672           | 60,706           | 11,586           | 58,354           | 403.7%                          | -15%                            |
| <b>5.3 Totali 5.1+5.2</b>                     | <b>641,091</b>   | <b>686,846</b>   | <b>846,948</b>   | <b>872,161</b>   | <b>751,750</b>   | <b>778,519</b>   | <b>988,109</b>   | <b>926,895</b>   | <b>728,863</b>   | <b>-21.4%</b>                   | <b>-3%</b>                      |
| <b>6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3</b>           | <b>6,813,647</b> | <b>4,454,681</b> | <b>6,839,765</b> | <b>6,848,803</b> | <b>6,940,395</b> | <b>6,661,515</b> | <b>6,947,154</b> | <b>6,799,859</b> | <b>6,565,007</b> | <b>-3.5%</b>                    | <b>-5%</b>                      |

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP


Bazuar në të dhënat e tabelës 1.1, shikojmë një rënie të totalit të zërit shërbim universal postar, në T1\_2022 krahasuar me T4\_2021, dhe kemi një rritje të këtij zëri krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Në lidhje me shërbimin jouniversal postar, të Postës Shqiptare, shikojmë një rritje të zërit *postë brenda vendit* dhe një rënie të zërit *postë ndërkombëtare*, në T1\_2022 krahasuar me T4\_2021. Zëri *ekspres brenda vendit* dhe *ekspres ndërkombëtar*, për Postën Shqiptare, rezulton në rritje krahasuar T1\_2022 me T1\_2021. Zërat *postë brenda vendit* dhe *postë ndërkombëtare*, në shërbimin jouniversal postar, për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, rezultuan me rënie për periudhën T1\_2022 krahasuar me T1\_2021. Zërat *ekspres brenda vendit* rezultoi me rritje në T1\_2022 krahasuar me T4\_2021.

**Tabela 1.2:** Totali i objekteve postare-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T4\_2021

|                    | Objekte postare  | Pjesë tregu |
|--------------------|------------------|-------------|
| <i>P.Sh</i>        | 5,487,901        | 84%         |
| <i>Of. e tjerë</i> | 1,077,106        | 16%         |
| <b>Totali</b>      | <b>6,565,007</b> | <b>100%</b> |

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafiku 1.1:** Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rënie në objektet postare në T1\_2022 krahasuar me T4\_2021, si për Postën Shqiptare ashtu edhe për ofruesit e shërbimeve postare, gjithashtu kemi një rënie të totalit të objekteve postare krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.


**Tabela 1.3:** Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1\_2022

| Sh.U      | Sh. jo univers. | Sh.ekspres | Totali    |
|-----------|-----------------|------------|-----------|
| 5,245,816 | 428,738         | 890,453    | 6,565,007 |
| 79.9%     | 6.5%            | 13.6%      | 100%      |

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 79.9%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 13.6% dhe shërbimi jo universal 6.5%.

**Grafiku 1.2:** Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T1\_2022 me periudhën T4\_2021 vërehet një rënie e shërbimeve postare me 3.5%, gjithashtu rënia vërehet dhe krahasuar me të njëjtën periudhë, një vit më parë, në vlerën 5%.

## 2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare


**Tabela 1.4:** Shërbimi Universal Postar T1\_2022

| Shërbimi Universal Postar |                  |
|---------------------------|------------------|
| Postë brenda vendit       | 5,087,129        |
| Postë ndërkombëtare       | 158,687          |
| <b>Totali</b>             | <b>5,245,816</b> |

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T1\_2022, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,087,129 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 97% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 3% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 4,340,563 shërbime për objekte të thjeshta dhe 746,566 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 26,256 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 132,431 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

**Grafiku 1.3:** Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, shikohet një rënie e shërbimit universal postar në T1\_2022 krahasuar me T4\_2021, me 1.6%.

### 3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

**Tabela 1.5:** Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P.Sh


| Llojet e shërbimeve         | Nr. Objekteve | Pjesë tregu T1_2022 | Pjesë tregu T1_2021 |
|-----------------------------|---------------|---------------------|---------------------|
| Shërbim universal postar    | 5,245,816     | 96%                 | 95%                 |
| Shërbim jo universal postar | 80,495        | 1%                  | 3%                  |
| Shërbim ekspres             | 161,590       | 3%                  | 3%                  |

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 96%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 3% dhe nga shërbimi jo universal postar 1%.



**Grafiku 1.4:** Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rritje për shërbimin universal dhe për shërbimin ekspres në T1\_2022 krahasuar me T1\_2021, si dhe një rënie për shërbimin jo universal postar. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm kemi një rënie të shërbimit universal dhe të shërbimit ekspres dhe një rritje të shërbimit jo universal postar.

#### 4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

**Tabela 1.6:** Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

| Ofruesit      | Nr. Objekteve  | Pjesë tregu T1_2022 | Pjesë tregu T_2021 |
|---------------|----------------|---------------------|--------------------|
| P.Sh          | 80,495         | 19%                 | 16%                |
| Of. e tjerë   | 348,243        | 81%                 | 84%                |
| <b>Totali</b> | <b>428,738</b> | <b>100%</b>         | <b>100%</b>        |

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafiku 1.5:** Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T1\_2022 krahasuar me T4\_2021 kanë pësuar rritje për Postën Shqiptare dhe një rënie të vogël për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T1\_2022 përbëhet nga 412,071 objekte brenda vendit dhe 16,667 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

## 5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2022, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2021, mbi baza tremujore.

**Tabela 1.7:** Shërbimi ekspres-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për T1\_2022

| Ofruesit      | Nr. Objekteve  | Pjesë tregu T1_2022 | Pjesë tregu T1_2021 |
|---------------|----------------|---------------------|---------------------|
| P.Shqiptare   | 161,590        | 18%                 | 17%                 |
| Of. e tjerë   | 728,863        | 82%                 | 83%                 |
| <b>Totali</b> | <b>890,453</b> | <b>100%</b>         | <b>100%</b>         |

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafik 1.6:** Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T1\_2022 ka pësuar rënie krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë ashtu edhe me tremujorin paraardhës T4\_2021.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 827,107 objekte postare ose 93%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 63,346 objekte postare ose 7%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 37,489 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 25,857 objekte.